

## SFIDA TË INTEGRIMIT DHE PËRJASHTIMIT SOCIAL TË GRUPEVE ROME NË KOMUNËN LEVAN, NË JUG TË SHQIPËRISË CHALLENGES OF INTEGRATION AND SOCIAL SEGREGATION OF ROMA PEOPLE IN LEVAN COMMUNE, SOUTHERN ALBANIA

NEVILA KOCOLLARI ( FURXHIU)

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Edukimit

Email: kocollari@hotmail.com

### ABSTRACT

The study introduces the challenges that emerge from roma tradition and strengthen points that encourage the social integration of roma people living in Levan commune, the most ancient roma community in Albania . There are two roma groups living there each with different experiences and expectations: *meckara*, often connected with integration and *kallbuxh*, traditionally ambulant but nowadays with fixed dwelling places. The fundamental point of the study is the dilemma, if roma social segregation comes out as production of ethnicity's perception, or it is influenced by the culture of poverty. The findings indicate that the biggest challenge that roma people report continuously to integration's process is *begging*, which brings for them enough income to challenge the other employment models. By the other side, the models of groups socially integrated, bring an incite to change mentality, especially among the roma's youth which are more attentive towards the school and business.

**Key words:** roma people, begging, integration, strategy, prejudices.

### PËRMBLEDHJE

Punimi paraqet sfidat që tradita rome vendos përballë integrimit social dhe pikat e forta që nxitin këtë proces për grupet rome në komunën e Levanit, komuniteti më i hershëm rom në Shqipëri, i ndarë në dy fise me eksperiencë të ndryshme: fisi *meçkara*, i lidhur më shumë me integrimin, dhe *kallbuxhët*, tradicionalisht shëtitorë, sot më pak. Punimi tenton të gjejë një përgjigje në lidhje me pyetjen, nëse përjashtimi social i romëve është produkt i perceptimeve të përkatësisë etnike, apo ndikohet nga

kultura e varfërisë. Gjetjet tregojnë se sfida më e madhe që romët vazhdojnë të raportojnë përballë integrimit, është *lypja*, sidomos për romet *kallbuxhe*, nga e cila ata sigurojnë të ardhura që sfidojnë modelet e tjera të punësimit dhe edukimit. Nga ana tjetër, modelet e familjeve rome socialisht të integruara, janë vazhdimisht një shtysë për ndryshimin e mentalitetit, sidomos tek të rinjtë romë, që kanë nisur të kthejnë sytë nga shkolla dhe biznesi.

**Fjalët çelës:** romë, lypje, integrim, strategji, paragjykim.

*Njëherë Zoti udhëtoi nëpër botë. Thirri një arixhi, i dha një thes të madh dhe i tha:*

*"Merre, çoje sa më larg dhe hidhe në lumë. Arixhiu, që mendonte se në thes kishte flori, pasi eci e eci, vendosi ta hapte. Sa e zgjidhi, dolën jashtë brumbuj, bretkosa, gjarpërinj, hardhuca dhe u shpërndanë në tokë. Zoti i inatosur, e ktheu arixhiun në lejlek dhe i tha: "Ti do ta kalosh gjithë jetën si lejlek, derisa të mbledhësh të gjitha krijesat!" Dhe akoma lejleku është duke i mbledhur ato nëpër botë.*

*Terren, nëntor 2008, treguar nga një rom: R. Dule*

### HYRJE

"*Arixhinjtë e Levanit*", është një shprehje tipike shqiptare, që simbolizon episode sjellore, lidhur me lëvizjet e shumta, të tepruara të njerëzve nga një vend në tjetrin, bagazhet e ekzagjeruara për udhëtim, nxirren e tepërt nga rrezet e diellit në verë. Përveç se krahason, ajo tregon edhe faktin, se popullata rome e Levanit, ka qenë më e njohura për popullsinë shqiptare. Nuk ka shifra të sakta për popullatën rome, sepse asnjë regjistrim zyrtar në Shqipëri nuk i ka evidentuar romët, edhe pse jetojnë në shumë zona të

vendit ( INSTAT, Buletini Statistikor, 2003).<sup>2</sup> Punimi është një përpjekje për të treguar fizionominë e grupeve rome në komunën e Levanit, duke u përqendruar tek modelet e integritit dhe historitë gojore të tyre. Synohet nxjerrja në pah e vlerave të komunitetit rom, si pika të forta përballë të dobëtave në kushtet e tranzicionit post-komunist, për të tentuar integrimin e romëve në shoqërinë e gjerë. Objektivat e punimit lidhen me identifikimin e formave të vlerësimit për përjashtim-integrimin dhe kulturën e varfërisë, përcaktimi i kufizimeve sociale që pengojnë rritjen e komunitetit rom, në këndvështrimin e integritit social të tyre, punësimin dhe edukimin, si edhe evidentimi i vetëefikasitetit të romëve për identitetin, kulturën dhe realitetin e tyre, zgjimi i tyre kulturor dhe gatishmëria për të ndryshuar përmes prezantimit të potencialeve të kulturës rome. Përveç literaturës së konsultuar, i është dhënë rëndësi historive gojore të treguara nga banorët e të intervistuarit, për ta kuptuar e prezantuar qartë situatën e dy grupeve që përballen. Levani ka rreth 500 familje rome, të regjistruara, të ndara në dy grupe të mëdha: *meckara*, pronarë tokash dhe *kallbuxhët*, që nuk kanë tokë. Vëzhgimi i grupeve rome që bashkëjetojnë në një territor, sjell mundësi të mira krahasimi për modelet e jetesës që zhvillojnë grupet përkatëse. Gjetjet tregojnë se sfida më e madhe që një pjesë e romëve (*kallbuxhët*) i bëjnë integritit social të tyre është *lypyja*. Pikërisht *lypyja*, i diferencon grupet rome nga njëri-tjetri. Çështjet janë parë nën dritën e *punës sociale*, profesion që ndikon në ndërtimin e kapaciteteve ndihmëse, në ndërgjegjësimin e romëve për vlerat e tyre dhe në orientimin e mundësive, sipas politikave të zhvillimit të zonës.

### Metodologjia e studimit

Baza teorike e punimit përbehet nga konsultimi me materiale dhe informacione zyrtare vendase dhe të huaja, por duke qenë se informacionet teorike në lidhje me grupet rome janë të pakta, baza kryesore e të dhënave vjen nga terreni, historitë gojore dhe opinionet e mbledhura përmes intervistave gjysmë të strukturuar, nga banorët romë të të dy fiseve, si dhe banorë jo romë të zonës së Levanit. Intervistat u zhvilluan në shtëpitë e romëve dhe në mjediset rreth tyre. Për individët joromë, intervista fokusohet në

këndvështrimin për romet dhe përfshirjen e tyre në zhvillimin e komunës. Gjatë procesit të analizës, gjuha është ruajtur origjinale. Hartëzimi përshkruan targetin nga pikëpamja hapësinore, demografike, urbanistike dhe nga pikëpamja e infrastrukturës, si dhe mentalitetin e romëve *kallbuxhë* e *meckara* në lidhje me hapësirën dhe vendin ku kanë jetuar e jetojnë. Shqyrtimi i të dhënave u mbështet tek analiza përshkruese dhe dinamike. Analiza e intervistave, për të qenë dinamike, iu nënshtrua zberthimit tematik, me qendër të intervistuarin dhe idetë e tij. Karakteri përshkrues lidhet me përshkrimin dhe interpretimin e fenomenit të pranimit-përjashtimit, mbi bazën e tipologjisë së të intervistuarve.

### Situata dilematike e grupeve rome në Levan

Flasim për një komunitet rom, nëse i referohemi konceptit të dhënë nga Toennies, në librin *Comunità e Società* ( F. Toennies, 1979, f. 51), ku spikatim tri nivelet: komuniteti me lidhje gjaku, i vendit dhe ai shpirtëror. Këto nivele janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe përmes tyre realizohen lidhjet e familjaritetit, fqinjësisë dhe miqësisë. Sipas "Pakicat dhe mbrojtja e të drejtave të tyre në Shqipëri, Konventa, legjislacion, raporte dhe materiale shpjeguese mbi pakicat kombëtare", botim i QSHNI, Tiranë 2004, f.155, pohohet se romët në Shqipëri janë minoritet gjuhësor që jeton i lirë, jo në kampe. *Arixhinjtë*, jemi mësuar t'i perceptojmë si popull pa atdhe, fakt që konfirmohet dhe nga te gjitha burimet e literaturës ndërkombëtare. Romët jetojnë në Shqipëri që prej më tepër se 600 vitesh (A.Trushaj, historian, 2009)<sup>3</sup>. Ata kanë arritur në Shqipëri para pushtimit Otoman dhe për arsye sigurie, kanë ndryshuar besimin e tyre fetar, në besim myslyman, siç bëri një pjesë e mirë e popullsisë shqiptare në atë kohë. Gjatë Luftës II Botërore, romët e Shqipërisë nuk u persekutuan në kampet e vdekjes, siç ndodhi në shumë vende të Evropës Lindore. Ata kanë marrë pjesë në luftë me ushtrinë shqiptare kundër pushtuesve të huaj. Pas luftës, shteti shqiptar ndoqi politikën e asimilimit ideologjik dhe të homogjenizimit të kombit shqiptar duke e konsideruar këtë komunitet si pjesë të popullsisë shqiptare, por deri në vitin 1960 romët e Shqipërisë bënin ende jetë nomade.<sup>4</sup> Mendohet se urbanizimi që i imponoi shteti komunist shqiptar romëve, bëri që pjesa më e madhe e tyre të humbasin gjuhën. Ata nuk e shkruajnë gjuhën e tyre dhe nuk kanë asnjë shkolle ku ta mësojnë atë. Në përputhje me politikën e punësimin të plotë, shteti komunist ishte i

<sup>2</sup> Në dokumentin e qeverisë shqiptare, "Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom", Tiranë, Prill 2003, thuhet se regjistrimet e para për romët në Shqipëri datojnë gjatë viteve 1522-23 dhe nga ky proces u vlerësuan rreth 1,270 vetë. Universiteti i Marylandit në 1995 deklaroi se ka deri në 120,000 romë që jetojnë në Shqipëri ("*INDEX ON CENSORSHIP*", Nr. 4.: 5-98).

<sup>3</sup> Interviste, Dr. A.Trushaj, Universiteti "I.Qemali" Vlore

<sup>4</sup> "Pakicat dhe mbrojtja e të drejtave të tyre në Shqipëri", Tiranë 2004

detyruar t'i siguronte punësimin si burrave, ashtu edhe grave, në funksion të nivelit të shkollimit dhe të aftësive të tyre. Në vitet 1990-ë, shqiptarët u njohën me termat "*Rom*" dhe "*Gypsies*" (Marushiakova & Popov, 2003)<sup>5</sup>. Me përmbysjen e komunizmit dhe me fillimin e ndryshimeve demokratike, romët ishin të parët që humbën punësimin dhe shkuan me shpejtësi në fund të klasifikimit social. Fëmijët romë u shndëruan masivisht në lypsa dhe viktime të trafikëve të ndryshme të personave dhe organeve, si dhe të prostitucionit. Nga studimi paraprak i Ministrisë së Punës dhe Cështjeve Sociale, për hartimin e Strategjisë Kombëtare për komunitetin rom (Tiranë, 2003), rezultoi se situata ekonomike e romëve të Shqipërisë dhe kushtet e jetesës janë në nivele shumë të ulta për shkak të papunësisë, që është në shifra disa herë më e madhe se pjesa tjetër e popullsisë jo romë. Kushtet e shëndetit dhe të strehimit kanë qenë dhe janë shumë të këqija për një pjesë të madhe të tyre, fakt që i klasifikon ata si grupe të varfra në Shqipëri (De Sotto, H., Gëdeshi, I., Beddies, S., Perez, D., 2003).

Aktualisht, të dy grupet romë, raportojnë se ndiejnë diferenca të dukshme me pjesën më të madhe të popullsisë. Nga ana tjetër, arrijnë të kuptojnë se përkrijnë në vlera me mazhorancën, por nuk mund t'i pranojnë të gërshetuara në këmbim të zhvillimit. Romët janë të vetëm në përballimin e problemeve, sepse e quajnë veten primitivë karshi të tjerëve dhe tërhiqen për të mos u përzierë në shoqërinë e madhe. E ndërsa këto konstatime janë dilema të përditshme tek *kallbuxhet*, tek romët *meçkara* perceptohen ndryshe. Së brendshmi, ka ndërthurje të zakoneve, traditave, të komunitetit rom dhe jorom, për shkak të jetëgjatësisë së qëndrimit të romëve, sidomos atyre meçkara këtu dhe përshtatjes me mënyrën e jetesës, gjuhën, nevojën për të jetuar, etj. Kështu meçkara prazantohen si banorët e parë të zones dhe ata paraqiten si shqiptare të hershëm. Ndërkohë *kallbuxhët*, janë tipizuar shëtitës, por sot lëvizin pak, vetëm për qëllime biznesi. Për romët që bëjnë punë të barabarta me komunitetin e mazhorancës dhe ndajnë konceptime pothuaj të njëjta së bashku, situata e pranimi dhe integritet duket më e lehtë. Ata mund të

sigurojnë përkrahje e mbështetje më të madhe se të tjerët, siç ndodh me meçkarat. Një pjesë e parajgykimeve qëndrojnë brenda vetë grupeve romë, kur bëhet dallimi midis rezidentëve (*meçkara*) dhe shëtitësve (*kallbuxhë*). *Kallbuxhët* prezantohen si fanatikë të traditës romë, asaj pjese që lidhet me lypjen, magjinë dhe të qenit person në nevojë. Ata konvertuan në lekë tokën e ndarë nga komuna dhe aktualisht ankohen se nuk kanë asgjë, gjë që i bën jostabël në raport me vendin ku jetojnë. Sipas tyre, mungesa e pronësisë i detyron të dalin në rrugë për të lypur. Këto janë elementet kyçe që krijojnë një hendek të dukshëm fizik dhe psikologjik midis grupeve romë, që janë shumë armiqësore mes tyre. Ata vështirë se krijojnë familje të përziera mes tyre, madje janë më të prirur drejt miqësive me jo romët, sesa me *kallbuxhët*<sup>6</sup>.

Para 1990-s, romët tregojnë se nuk dinin asgjë për historinë e tyre, përveç faktit që kishin prejardhje nga India. Ata nuk e njihnin flamurin e tyre si simbol kombëtar. Romët *kallbuxhë* jetojnë në shtëpi të palegalizuara, por kanë ujë të pijshëm dhe energji elektrike.

Në eksperiencat shqiptare të sistemit komunist, tendenca e orientuar drejt unifikimit të vlerave, përmes presionit ideologjik e politik, u duk edhe tek komuniteti rom, i cili e konsideronte veten si pjesë të proletarietit e klasës punëtore. Romët meçkara të Levanit, arritën të përfaqësoheshin në instancat politike me delegatë nëpër kongrese, si anëtarë të Partisë së Punës (Sulo D., rom)<sup>7</sup> dhe organeve të tjera drejtuese.

### Modelet e zhvillimit

Romët në Levan flasin gjuhën e tyre, që ndryshon sipas fiseve, por edhe shqip. Fëmijët romë që shkojnë në shkollë, mësojnë në gjuhën shqipe, pasi nuk ka mësuës të gjuhës romë. Ata i marrin shërbimet që gjenden në zonë, njësoj si të bardhët.

Statusi ekonomik i romëve është i vështirë, ndonëse e kaluara sjell një traditë punësimi. Niveli i ulët i të ardhurave dhe papunësia ndikohen nga analfabetizmi, tradita romë për ekonominë dhe raportet me popullsinë joromë. Përrjashtimi, më tepër, lidhet me kushtet e jetesës së romëve, ndikuar fort nga përkatësia etnike. Romët shihen të lidhur me punët e

<sup>5</sup> Në zhargonin e përditshëm të shqiptarëve, këto grupe njihen si: *arixhinjtë dhe jevgjit* (Kurtade, M., 2004). Termi "*Gypsies*" është shpikur nga evropianët, që besonin se romët e kishin origjinën e tyre në Egjipt. Në Shqipëri, grupet që përfaqësohen me këtë origjinë mendohet se janë Jevgjit (Petrova, D., 2003).<sup>5</sup> Në vitet në vazhdim termat e mësipërm, nisën të bëhen pjesë e diskutimeve në lidhje me pakicat etnike, ato gjuhësore, të drejtat e njeriut, integritimin e shoqërizimin si dhe dallimet në perceptimin dhe pranimin e këtyre grupeve të veçanta (GSHDNJ, 2003).

<sup>6</sup> Bëhet fjalë vetëm për marrëdhëniet mes grupeve romë dhe jo mes romëve dhe jevgjitve. Këto të fundit janë edhe më armiqësore, sepse romët mendojnë se jevgjit kanë tradhëtuar traditën e tyre të përbashkët duke humbur gjuhën dhe zakonet romë (Intervistë R.D., rom, Levan).

<sup>7</sup> Intervistë me z. S.D., rom në Levan, ish-delegat në kongreset e PPSH-së dhe anëtar i kësaj partie. Sot pensionist.

rëndomta e pak të paguara dhe me lypjen, duke menduar se ata kënaqen me pak. Për fisin *meçkara* të ardhurat sigurohen nga emigracioni e puna e krahut dhe ata shprehen të knaqur, madje edhe kursejnë për fëmijët. Për *kallbuxhët*, tregtia e prodhimeve artizanale, lypja, muzika, janë baza e sigurimit të të ardhurave. Familjet më të varfra marrin me listë ushqime e artikuj të nevojshëm. Ata që lypin, thonë se fitojnë 200-300 lekë (gati 2 Euro) në ditë, por që, sipas tyre, nuk u mjafton. Një llogari e thjeshtë, për një familje që nxjerr për lypje gruan dhe fëmijët, tregon se një mesatare e tillë të ardhurash të bën ziliqar. Sipas B., “... ata duken të varfër, por e di sa nxjerrin nga lypja? Bëj provë e kontrolloji palat e rrobave, kanë plot para”. Të besosh tek lypja është njëherësh paradoks dhe sfidë ndaj përpjekjeve integruese.

Në lagjen e romëve sheh njerëz të veshur mirë, edhe pse sipas traditës rome. Ishin shumë mikpritës. Hapnin dyert e shtëpive dhe qerasnin me gjërat më të mira që u ndodheshin në shtëpi. Dallimi midis dy fiseve ishte i dukshëm. Në fillim shtëpitë e reja dhe të rikonstruara të jepnin idenë e një komuniteti rural të çfarëdoshëm në Shqipëri, por, më tej, edhe pse të lyera me gëlqere, shtëpitë prej balte të kujtonin skamjen dhe izolimin. Banesat e *kallbuxhëve*, të ndërtuara me kallama e baltë, pikonin dhe paraqitnin rrezikshmëri në dimër nga përmytja, kurse në verë nga zjarri. Nuk ka si të ndodhë ndryshe, kur burra që luajnë bixhoz në bar, presin një dorë parash nga gruaja e fëmijët që kanë dalë në rrugë të lypin. Që këtu nis thithja e modelit të jetës së ardhme të fëmijës dhe këmbëngulja e nënës që, qysh në djep, fëmija të mësojë se ç’është mbijetesa. Cila pjesë e integritit u takon këtyre fëmijëve, që të ftohtët dhe të nxehtët u kanë rregjur lëkurën e fytyrën që në djep? Duket sikur kjo mënyrë e zgjedhur për të qenë mes njerëzve, në fakt, i përjashton ata më tepër. Nga ana tjetër, *arti i të lypurit* edukon indiferencën dhe mungesën e vullnetit për punën. Por edhe këtu, paradokset nuk kanë të sosur. Sipas M. (e cila të ardhurat e përditshme i merr nga lypja): “Po bëj shtëpi me soletë. Do mbaroj, të jetojmë në rregull”.

*Përtacia* e romëve *kallbuxhë*, është një element i dukshëm distancues për ta në raport me të tjerët, por dhe mes grupeve rome. Sipas opinioneve të mbledhura, *kallbuxhët*, i bëjnë “naze” punës, pasi ajo është jashtë ritmit të traditës dhe jetës lëvizëse. Ata besojnë se duke u dhënë shteti asistencë do të jetojnë më mirë. Romët *meçkarë* nuk besojnë ndonjëherë se *kallbuxhët* mund të bëhen punëtorë të qëndrueshëm e të shkollojnë fëmijët, sepse janë të pacivilizuar. Sipas H.B., banor i Levanit: “Kohë më parë, në monizëm, i morën romët *kallbuxhë* dhe i çuan në Durrës për punë. Për 20 ditë erdhën të gjithë, me kurriz të përvëlur nga

saldaturat, duke bërëtitur se nuk punonin më. Që atëherë, unë nuk kam parë nga ai fis të zënë punë me dorë. Të lypin, po, tjetër gjë, aha”.

Romët *kallbuxhë* e ndiejnë në palcë diferencimin me “të tjerët”, dhe, duke e parë që rruga për të ndryshuar është shumë e mundimshme, vazhdojnë stereotipet e tyre, ritualet e mbijetesës, mbledhjes së kanaçeve e lypjes nëpër rrugë. Romët në përgjithësi, i konsiderojnë të bardhët të paarrtshëm dhe veten e tyre të pandreqshëm. Rrjedhojë e kësaj logjike është izolimi psikologjik e më pas social, ekonomik, politik. Nga ana tjetër, gabimet atributive që të tjerët bëjnë me romët, ndikojnë drejtpërsëdrejti në aktivitetin rehabilitues, sepse sjellin uljen e shpejtësisë integruese të romëve në jetën e gjerë. Në vazhdim të idesë, edhe trajtimi me superlativa i vështirësive të grupeve rome, jo vetëm nuk zgjidh problemet, por i thellon më tej, duke futur një frymë fataliste në grupet nevojtare dhe kështu, kalvari i paragjyqimeve vazhdon.

## KONKLUZIONE

Sfidat në mjedisin rom në Levan janë të mëdha; nga njëra anë dëshira për integrim, nga ana tjetër rrënjëzim i *kallbuxhëve* tek lypja, e cila mundëson fuqizimin problematik të tyre, pasi me te ardhurat e siguruara nga lypja ata sigurojnë vendstrehim dhe ushqim. Tradita i detyron romët të jenë të izoluar, ndërsa zhvillimi i gjen të papërgatitur psikologjikisht dhe moralisht të kapërcejnë pengesa e paragjyqime për një status e pozicion social me dinjitet. Kjo dilemë duket se do të vazhdojë për sa kohë mungon zbatimi i strategjisë kombëtare për romët. Ndonëse grupet rome dallojnë mes tyre, përsëri mbeten të varfra dhe në nevojë, pasi edhe brezat e rinj të romëve *meçkara* ose emigrojnë, ose punojnë, duke qenë të përjashtuar relativisht nga edukimi.

Proçeset e rritjes urbane dhe tranzicioni shqiptar, nuk zbutin izolimin për romët, por rritin mundësinë e thellimit të paragjyqimeve. Kjo tregon koston e lartë që tranzicioni vendos për këto grupe. Ky realitet nuk prek vetëm raportet mazhorancë-romë, por dhe vetë grupet rome, që komunikojnë keq ndërmjet tyre për zonat e zotërimit të “tregut të pronave”, atij të punësimit, prirjes së shkollimit etj. Në një situatë ku puna e vazhdueshme pothuaj mungon, duhet stimuluar edukimi i fëmijëve dhe brezave të rinj, si edhe çelja e kurseve artizanale profesionale, si rrobaqepësi, punim hekuri, për të aftësuar ata që nuk pranojnë të shkollohen. Duhet tërhequr në programe të tilla gratë, simboli i lypjes, bashkë me fëmijët. Duke mundësuar profesionet *para-sjellës*, ndryshimet në mentalitet do të jenë më afër. Roli i punonjësve socialë në zonë duhet të ketë një synim specifik, për të njohur bazën historike e mentalitetin e romëve, në mënyrë që

ngjarjet rehabilituese të jenë lehtësisht të realizueshme në kohë e hapësirë.

#### **BIBLIOGRAFIA**

1. De Certeau, Michel. 1984. *The practice of everyday life* (trans. S.Rendall). Berkley: University of California Press.
2. De Sotto, H., Gëdeshi, I., Beddies, S., Perez, D., (2003) *Romët dhe Jevgjit në Shqipëri: nga përjashtimi social drejt përfshirjes sociale*. Banka Botërore, OSFA, UNDP, Ambasada Amerikane, Agjensia Zviceriane për Zhvillim e Kooperim, Tiranë.
3. Hancock, Ian " *We Are the Romani People*". Hatfield: University of Hertfordshire Press, 2002.
4. Kurtade, Marcel, (2004) *Elemente refleksioni mbi ballkano-egjiptianët*, INALCO (Instituti Kombëtar i

- Gjuhëve dhe Qytetërimit Oriental), Gazeta "Dita" dt.19,20,21,22. Tirane. 12,13,14,15
5. Marushiakova, Elena and Vesselin Popov. (2000) *The Gypsies in the Osman Empire* Litavra, Sofia.
  6. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (2003) *Projekt Strategji për përmirësimin e ushteve të jetesës së minoritetit rom*, Tirane.
  7. Petrova, D., *The Roma: between a myth and the future*". Social Research, 2003.
  8. Qendra Shqiptare per te Drejtat e Njeriut "Pakicat dhe mbrojtja e te drejtave te tyre ne Shqiperi", Tirane, 2004
  9. Toennies, F., (1887) *Gemeinschaft und Gesellschaft*, përkthyer në italisht *Comunè e società* ,
  10. UHPLIS, (1998) *INDEX ON CENSORSHIP*. Gypsies, Nr. 4 University of Hertfordshire Press, Learning and Information Services, 5-98.